

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Kolegji i përbërë nga gjyqtaret Shqipe Qerimi, Kryetare, Rasim Rasimi dhe Gani Zabeli, anëtarë me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.S. nga K. e Kamenicës, për shkak të veprës penale nga neni 80 parag.2 lidhur me parag.1 të Ligjit për Minierat dhe Mineralet të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji 04/L-158, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë, P.nr.179/2015 të datës 11.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 06.03.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë, P.nr.179/2015 i datës 11.11.2016, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë me aktgjykimin P.nr.179/2015 të datës 11.11.2016, të akuzuarin V.S., e ka shpallur fajtor, për shkak të veprës penale nga neni 80 parag.2 lidhur me parag.1 të Ligjit për Minierat dhe Mineralet të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji 04/L-158, dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 300 (treqind) Euro, të cilën shumë ka për ta paguar duke filluar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi apo në të kundërtën i njëjti dënim me gjobë do ti zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për çdo 20 Euro do t'i llogaritet nga një ditë burgu.

Të akuzuarin e ka obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro, në afat prej 15 ditësh prej marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Palën e dëmtuar në këtë rast KPMM-ja në Prishtinë e ka udhëzuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokuroria Themelore në Gjilan për shkak të shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale nga neni 383 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4. lidhur me nenin 387 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj

ankesën si të bazuar dhe të ligjshme, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarit ti shqiptojë dënim në pajtim me nenin 80 par.1 të LMM të RK).

Prokurori i Apelit me parashtresën PPA/II.nr.39/2017, të datës 24.01.2017, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan të aprovohet si e bazuar, kurse ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënimi konform nenit 80 par.1 të LMM të RK.

Gjykata e Apelit e Kosovës, mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet në ankesë gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi dhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP-së, dhe gjeti se aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të Ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase siç rezulton nga shkresat e lëndës i akuzuari e ka pranuar fajësinë, prandaj, sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë, ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, andaj ankesa e mbrojtësi të akuzuarit për këtë bazë është e palejuar.

Sipas pretendimeve të Prokurorit gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit nuk i ka marr parasysh rrethanat rënduese si shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale, shkallën e lartë të dashjes nga ana e personit të dënuar, po ashtu nuk ka pasur parasysh që kjo vepër penale është kryer në kohën kur organet kompetente të Kosovës bënë fushatë për ta mbrojtur ambientin nga degradimet e këtilla që kompanitë si kjo shkaktonin ambientin e Kosovës.

Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se këto pretendime ankimore të Prokurorit që ankesa e tij të aprovohet dhe ndryshohet sa i përket vendimit të dënimit dhe ndaj të akuzuarit të shqiptoj dënim me burg nuk qëndrojnë. Gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit i vlerësoi dhe analizoi rrethanat që ndikojnë në matjen dhe caktimin e dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, sjelljen korrekte në gjykatë, është penduar thellë për kryerjen e veprës penale, makineritë në seperacion i ka çmontuar nga viti 2015 dhe nuk ushtron më këtë veprimtari, premtion se në të ardhmen nuk do ta përsërisë vepër tjetër penale, gjendjen jo të mirë ekonomike, ndërsa nuk gjeti rrethana veçanërisht rënduese.

Vlerësimin e këtyllë të rrethanave relevante për matjen e dënimit e pranon edhe kjo gjykatë, prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka

konstatuar gjykata e shkallës së parë, rrethanat e rastit konkret e posaçërisht duke ia marr për bazë edhe pranimin e fajësisë, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i parashikuar me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së, ku do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga kjo që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr. 14/17, me dt. 06.03.2017

Procesmbajtës
Hysni Ismaili

Kryetari kolegjit
Shqipe Qerimi

Anëtarët e kolegjit:

1. Rasim Rasimi
2. Gani Zabeli